

## **Dr. Desara Agaj**

Përgjegjëse në Sektorin e Kurrikulave në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Tiranës.

Znj. Agaj ka një përvojë pune 12 vjeçare si personel akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në Institucione të Arsimit të Lartë private dhe publike në Republikën e Shqipërisë si dhe eksperiencë në çështjet administrative që lidhen me programet mësimore, sigurimin e cilësisë dhe akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Pas diplomimit në Universitetin e Shkodrës në 2007 në programin bachelor në Psikologji, znj. Agaj përfundon studimet master i shkencave në Universitetin e Tiranës në profilin Psikologji Shkollore dhe Organizacionale.

Në vitin 2016 merr gradën “*Doktor i Shkencave*” në fushën e Psikologjise në Universitetin e Tiranës, duke mbrojtur dizertacionin me temë “*Niveli i varësisë nga interneti. Roli i karakteristikave të përdoruesve në shpjegimin e varësisë nga interneti tek adoleshentët në Shqipëri*”.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë Psikologjinë e zhvillimit dhe Psikologjinë e edukimit.

Znj. Agaj ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Albanian University për gjatë viteve 2016-2020.

Anëtare e Senatit Akademik në Albanian University në vitin 2019-2020.

Anëtare e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulave në Albanian University nga viti 2018-2020.

Anëtare e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës nga viti 2020 dhe aktualisht.

Eksperte e jashtme pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vlerësimin e programeve të reja të studimit nga viti 2018 dhe aktualisht.

Ka botuar një sërë artikujsh në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti. Ka marrë pjesë në një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka qenë pjesë e projektit ndërkombëtar GRADUA si kërkuese shkencore.

Znj. Agaj është bashkëautore e tekstit universitar “*Psikologji zhvillimi për fëmijët me aftësi ndryshe*”, botuar në vitin 2018 si dhe e ciklit të leksioneve “*Edukim Special*”, botuar në vitin 2014.

Aktualisht, është përgjegjëse në Sektorin e Kurrikulave në Rektoratin e Universitetit të Tiranës dhe lektore me kohë të pjesshme në Universitetin “Luigj Gurakuqi”.